



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1321 Prot.

Tiranë, më datë 30.08.2021

VENDIM
Nr. 544, datë 30.08.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 30.08.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstrukcion Objekt Ekzistues 2 Kate + Nënçati”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, me aplikues dhe projektues restaurator Z. Zef Çuni, zhvillues Z. Anton Vata, shtyrë vendimmarrja me Vendim KKTKM Nr. 513, datë 03.08.2021;
 2. Subjekti duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 771, datë 30.09.2020 “Për deklarimin Pasuri Kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe miratimin e Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”. Neni 11, Pika 4:
 - Zbatimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori;
 - Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Shkodër;
 4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

